



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarsstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Nr./Br. 413/01-39746
Data/Datum 24.10.2019
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica / Municipality of Gjakovë

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Mjesia Org 17-01
Org./Ministria
Org. Unit

Nr. i Prot. 05
Prot. No.

Data 24.10.19
Datum
Date

Prishtinë / a

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAP SINOR

DHE

KOMUNËS SË GJAKOVËS

PËR

PROJEKTIN " TA PASTROJMË KOSOVËN "

Prishtinë, Tetor 2019

Duke marrë parasysh nenin 10 dhe nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), Nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe Nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Ligjin Nr. 06/1 -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 4 / 14 shkurt 2019, lidhe këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT

Projekti “ Ta Pastrojmë Kosovën “

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e përfaqësuar nga Ministri i MMPH-së (në tekstin e mëtejme MMPH),

dhe

2. Komuna e Gjakovës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandum Bashkëpunimi është të krijoj lidhje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Gjakovës dhe mbështetja financiare për projektin “ **Ta Pastrojmë Kosovën** ”

Neni 2

Koordinimi

Bashkëpunimi sipas këtij memorandum realizohet si vijon:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

1. MMPH financon këtë projekt në vlerë prej: 150,000.00 €.
2. MMPH-ja i zoton mjetet për projektin nga pika 1 e kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
3. Pagesat për bashkëfinancimin e Projektit “ **Ta Pastrojmë Kosovën** ” nga MMPH, do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, përveç avansit.
4. MMPH cakton një zyrtar monitorues lidhur me këtë projekt, i cili monitoron projektin nga fillimi deri në përfundim të kontratës dhe në momentin kur i vëren parregullsitë apo defektet gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MMPH-së.

Komuna e Gjakovës;

1. Komuna obligohet që t’i krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit “ **Ta Pastrojmë Kosovën** ” për operatorin ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesa të filloj implementimin (furnizimin) e projektit me kohë si dhe të siguroj specifikacionin teknik.
2. Komuna e kryen procesin e tenderimit, cakton komisionin e hapjes dhe vlerësimit të tenderit.
3. Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik;
4. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

5. Komuna obligohet që të njoftoj MMPH-në për çdo propozim ndryshim eventuale të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, dhe për këtë të kërkojë pëlqimin e MMPH-së.
6. Komuna obligohet që të vendos tabelën informuese (Panon) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik në vendpunishte/paisje.
7. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga ana e MMPH-së, të komplotojë këto dokumente :
 - 7.1 Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara).
 - 7.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare, të verifikuar nga origjinali prej menaxherit të prokurimit të komunës.
 - 7.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës.
 - 7.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara).
 - 7.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MMPH.
 - 7.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).
8. Komuna duhet të ndërmerret të gjitha masat që shuma e buxhetit e ndarë për këtë projekt sipas nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, të realizohet gjatë vitit buxhetor 2019.
9. Komuna është e obliguar të njoftoj MMPH për rrjedhat e realizimit të projektit sipas progresit të punimeve deri në përfundim të projektit.

Neni 3 **Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit**

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MMPH-së, dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MMPH-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i ka përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 4 **Zgjidhja e marrëveshjes**

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.


Neni 5
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në (2) dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëloj autentike.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Fatmir Matoshi
Minister i Mbrojtjes



Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës

